

Kryeministri do t'i godasë të pabindurit

[Gazeta Shqiptare, 31.3.2006]

Ngjau një gjë krejt e papritur: Komisioni i Ligjeve, një komision parlamentar i tërë, e jo vetëm një “kaptinë derr” si deputeti Ngjela, votoi kundër udhëzimeve të qarta të kryeministrit: vendosi që ligji për “Legalizimin e Zonave Informale” të rishikohet; e bile dha publikisht edhe vendimin e tij, se presidenti paska pasur të drejtë në pretendimet se ai ligj bie ndesh me Kushtetutën. E në këtë komision mungonte opozita, pra ata që votuan kundër urdhrave të kryeministrit, ishin të gjithë të maxhorancës, ishin vetëm ata “të kryeministrit”! E gjithë kjo, kur nuk kishin kaluar veçse pak ditë, nga mbledhja e grupit parlamentar të PD-së, ku kryeministri i “hiqte petët e lakrorit” të Presidentit të vendit, duke udhëzuar qartë deputetët e vet, që ligji në fjalë, sa do bënte një xhiro kot nëpër Kuvend, sepse prapë do të miratohej siç ishte, sepse “nuk kishte asgjë në shkelje të Kushtetutës”.

Ky qëndrim i deputetëve të komisionit të Ligjeve, na duket ndryshimi i parë pozitiv i PD-së aktuale, dhe na ringjall shpresën se brenda saj ka njerëz që kanë kurajon të shprehin mendimet e tyre edhe haptas: pa votim të fshehtë!

Po si do të reagojë kryeministri ndaj këtij fakti?

Jemi të sigurtë që kryeministri po përgatit silurimin e të gjithë atyre deputetëve që patën guximin të votojnë me “krye të vet”. Ne jemi të sigurtë për këtë, sepse kështu ka vepruar historikisht kryeministri aktual, dhe nuk jemi aq naivë sa të besojmë se ai ka ndërruar karakter pas moshës 60 vjeç. Bile, jemi të sigurtë se do të rregullohet që emrat e atyre deputetëve t'i bëhen të njohur bazës së PD-së, si edhe dënimi i tyre, që të bëhet mësim për të gjithë. Baza duhet të ketë frikë të mendojë ndryshe kryeministrit aktual, dhe jo më të veprojë kundër tij—të votosh kundra tij, kjo s'do mend që është një veprim kundër tij, natyrisht sipas tij.

Tani Ai po vret mendjen se ç'duhet të bëjë që kjo epidemi e mosbindjes së verbër ndaj tij, të mos hapet edhe në deputetët e tjerë.

Duhet të japë urgjentisht një goditje të tillë, që deputetët e tjerë ta marrin vesh qartë, por të huajt të mos marrin vesh gjë, se ia regjistrojnë si pikë negative. Këta të huajt që monitorojnë demokracinë në Shqipëri, “iu bënë ferrë kryeministrit aktual”, e kanë në shënjestër—nuk janë si shumë shqiptarë ata, që të harrojnë, si atë vitin e tmerrshëm 96-97, kur Ai ishte kryetar i shtetit që u shkërmoq, si dhe shumë e shumë bëma të tjera të tij!

Pra, goditja e deputetëve “rebelë”, duhet të jetë e tillë që të frikësohen si deputetët e tjerë, si edhe strukturat e PD-së në bazë.

Se ç'do të përdoret sot për t'i goditur, kjo është e vështirë të parashikohet me saktësi. Por drejtimet dihen: do të fabrikohen shpifje për deputetët në fjalë. Dikur fabrikonte se kanë qenë agjentë të sigurimit komunist, por tani kjo nuk para pin më ujë, jo sepse i mbaroi afati atij ligjit që ndalonte spiunët të bëhen deputetë, por sepse qenia ish-sigurims komunist, nuk është më aq pexhorative, aq e parë me sy të keq në PD-në aktuale: përderisa ata që kryeministri aktual u pati lexuar publikisht dosjet dhe pseudonimet e spiunllëkut, tani i ka bërë deputetë dhe përkrahësit e tij më të flakët. Sidoqoftë, do të sajojë ndonjë “konspiracion me socialistët, me Ramën apo fundja dhe me Nanon”, në ndonjë kafe, apo në ndonjë buzuqi, apo në ndonjë rrugë për në Amerikë. E po nuk ecën këto, do t'i shpifë si të korruptuar, por që do t'u nxjerrë faktet pak më vonë—pas nja “1000” vjetësh.

Sidoqoftë, ata deputetë, opinioni shoqëror shqiptar, duhet të gjejë mënyra t'u rrijë pranë: së paku t'u sigurojë një përkrahje morale, se me siguri kanë shumë nevojë për të. Masmedia nuk

duhet të bjerë viktimë e shpifjeve përkatëse mbi ta: çdo gjë negative që do të thuhet për ta, duhet të na rikujtojë guximin e tyre politik, qytetar, dhe të na bëjë të vëmendshëm se mos jemi para një forme goditjeje të orkestruar nga mekanizmat e kryeministrit aktual!

Bashkim Kopliku

Durrës, më 30.3.2009